




# **INTEGRIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR DHE STATISTIKOR**

**Hana Zoričić**  
Ministria e Financave  
prill 2018



# Vështrim i përgjithshëm i zhvillimit të kontabilitetit buxhetor në RK që prej vitit 2002 deri tani


---

- Ndryshimet më të mëdha në sistemin buxhetor kroat kanë ndodhur më 2001 dhe 2002
- Ndryshimet u bënë kryesisht për shkak të:
  - Nevojës për të zhvilluar dhe harmonizuar sistemin e klasifikimit me klasifikimet e rregulluara në nivel ndërkombëtar,
  - Nevojës për të përftuar informacione cilësore për operacionet e njësive të veçanta dhe të gjithë qeverisjes dhe
  - Nevojës për të qenë në përputhje me trendët globalë dhe kërkesat e përcaktuara nga sistemet statistikore ndërkombëtare (ndryshimi në parimin kontabël).

# Vështrim i përgjithshëm i zhvillimit të kontabilitetit buxhetor në RK që prej vitit 2002 deri tani

---

- Ndryshimi më i rëndësishëm metodik



**kalimi nga baza monetare në bazën e modifikuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara**

- Kalimi nga kontabilitetit me bazë monetare në kontabilitetin me bazë të modifikuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara lehtësoi një rol shumë më aktiv të kontabilitetit në proceset e buxhetit; kontabiliteti jo vetëm që i dha përgjigje pyetjes: çfarë është paguar, por edhe: sa janë shpenzuar.

# Vështrim i përgjithshëm i zhvillimit të kontabilitetit buxhetor në RK që prej vitit 2002 deri tani

---

- Që prej vitit 2002 të gjitha njësitë e qeverisjes zbatojnë një **plan kontabël të unifikuar** të ndërlidhur me kodet statistikore të GFS 2001.
- Plani kontabël është ndryshuar në përputhje me kërkesat për **klasifikimin ekonomik**
  - Përdorimi i klasifikimit ekonomik si bazë për identifikimin e llogarive të planit kontabël kërkonte një ndryshim total të planit kontabël i cili përfshinte disa klasifikime të ndryshme.
- Është ndryshuar edhe kuadri analitik i raportimit financiar (llojet, forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare) dhe është përshtatur me këtë sistem kontabël.

# Karakteristikat e kontabilitetit buxhetor në RK

---

- **Monitorim i gjithanshëm kontabël** – Kodi i Buxhetit rregullon të gjitha subjektet e kontabilitetit buxhetor dhe raportimit financiar.
- Zbatimi i një **plani kontabël të unifikuar** për buxhetet dhe përdoruesit buxhetorë në nivel qendror, vendor dhe rajonal (ndryshe nga shumë vende evropiane, me përdorim të njëjtë të një rregulle për kontabilizimin e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike).
- Zbatimi i klasifikimit buxhetor është i detyrueshëm – në të gjitha fazat e ciklit të buxheti (përgatitja, kontabiliteti dhe raportimi financiar i buxhetit):
  - Organizativ,
  - Ekonomik,
  - Funksional,
  - Sipas vendndodhjes,
  - Programor dhe
  - Burimet e financimit

# Sistemet kontabël dhe statistikore në RK

---

- Sistemet kontabël duhet të dallohen nga sistemet statistikore.
- Burimi kryesor i statistikave fiskale janë regjistrimet dhe raportet kontabël që dalin nga sistemet kombëtare të kontabilitetit.
  - Të dhënat e lartpërmendura janë faktorë kyç për marrjen e të dhënave statistikore, të cilat patjetër që ndikojnë në cilësinë dhe krahasueshmërinë e tyre.
  - Kjo ka pasur efekt edhe te nevoja për t'i përafruar sistemet e kontabilitetit buxhetor dhe raportimit financiar me sistemin statistikor, çka ka sjellë rritje të efikasitetit, shpejtësi dhe transparencë në nxjerrjen e të dhënave statistikore.
- Në krahasim me metodikat kontabël, metodikat statistikore shpesh janë më strikte dhe hyjnë në fushën e çmuarjeve ekonomike të të gjitha ngjarjeve/transaksioneve të rëndësishme dhe riklasifikimi i tyre varet nga një çmuarje e tillë.

# Sistemet kontabël dhe statistikore në RK

- Në 6-mujorin e dytë të vitit 2013 është përgatitur **Strategjia për Reformën e Sistemit të Raportimit Financiar** ku parashikohen masat për përmirësimin e raportimit financiar të buxheteve dhe përdoruesve buxhetorë dhe jashtëbuxhetorë në RK.
  - Trajtimi i ngarkesës së njësive raportuese, përmbushja e objektivave për statistikat dhe konsolidimin,
  - Përshtatja e afateve të raportimit me kërkesat e Raportit Fiskal (KE)
- dhe
  - Përmirësimi i cilësisë së të dhënave në pasqyrat financiare.
- Reformat kanë të bëjnë së pari me:
  - Përmbajtjen shtesë në planin kontabël,
  - Shqyrtimin e përmbajtjes dhe afateve të dorëzimit të pasqyrave financiare,
  - Thjeshtimin e konsolidimit nëpërmjet bërjes së dallimit midis të dhënave buxhetore vendore dhe rajonale dhe të dhënave të përdoruesve të tyre buxhetorë në pasqyrat financiare.
- Sistemi i ri Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010) që ka dalë në qershor 2013 dhe ka hyrë në fuqi në shtator 2014 jep arsytet shtesë për përmirësimin e kontabilitetit buxhetor dhe raportimit financiar
  - Në RK ESA 2010 përpilohet në bashkëpunim me CBS, CNB dhe MF.
  - MF është kompetente për të dhënat për planet (më së shumti llogaritë jo financiare), CBS për të dhënat historike – llogaritë jo financiare, CNB për të dhënat historike – llogaritë financiare.

MF  
CBS  
CNB

# Strategjia për Reformën e Sistemit të Raportimit Financiar – VËNIA NË ZBATIM

---

- Në tetor 2014 është miratuar një rregullore e re për kontabilitetin buxhetor dhe planin kontabël, që ndër të tjera përmban ndryshime në përputhje me rekomandimet e Eurostatit.
  - U bë i detyrueshëm kontabilizimi i **subvencioneve të dhëna dhe granteve kapitale** me të drejta dhe detyrime të konstatuara; me fjalë të tjerë, që në momentin kur një akt (vendim etj.) që cakton një subvencion ose grant kapital të tillë nxirret nga autoriteti kompetent dhe hyn në fuqi.
  - Në përputhje me kërkesat statistikore evropiane, parimi monetar i përdorur për njohjen e të ardhurave nuk mund të përdoret në rastin e **fondeve të BE-së**
    - Si përjashtim, në rastin e asistencës që japin institucionet dhe autoritetet e BE-së dhe asistencës nga buxheti i shtetit mbështetur në transferimin e fondeve të BE-së është rregulluar një parim për njohjen e të ardhurave në periudhën e raportimit përpjesëtimore me kostot e zbatimit të programeve dhe projekteve të kontraktuara.



# Strategjia për Reformën e Sistemit të Raportimit Financiar – VËNIA NË ZBATIM

- Në dhjetor 2014 është miratuar një rregullore e re për raportimit financiar në kontabilitetin buxhetor në përputhje me ndryshimet e bëra në rregulloren për kontabilitetin buxhetor dhe planin kontabël dhe kërkesat statistikore.
- NJË SHEMBULL I PASQYRËS TIP FINANCIARE:

Obvezni analitički podaci				
81641	Povrat zajmova danih tuzemnim obrtnicima - kratkoročni	819		
81642	Povrat zajmova danih tuzemnim obrtnicima - dugoročni	820		
81643	Povrat danih zajmova tuzemnim obrtnicima po protestiranim jamstvima	821		
81711	Povrat zajmova danih državnom proračunu - kratkoročni	822		
81712	Povrat zajmova danih državnom proračunu - dugoročni	823		
81721	<del>Povrat zajmova danih županijskim proračunima - kratkoročni</del>	824		
81722	Povrat zajmova danih županijskim proračunima - dugoročni	825		
81723	Povrat danih zajmova županijskim proračunima po protestiranim jamstvima	826		
81731	Povrat zajmova danih gradskim proračunima - kratkoročni	827		
81732	Povrat zajmova danih gradskim proračunima - dugoročni	828		
81733	Povrat danih zajmova gradskim proračunima po protestiranim jamstvima	829		
81741	<del>Povrat zajmova danih općinskim proračunima - kratkoročni</del>	830		
81742	<del>Povrat zajmova danih općinskim proračunima - dugoročni</del>	831		
81743	Povrat danih zajmova općinskim proračunima po protestiranim jamstvima	832		
81751	Povrat zajmova danih HZMO-u, HZZ-u i HZZO-u - kratkoročni	833		
81752	Povrat zajmova danih HZMO-u, HZZ-u i HZZO-u - dugoročni	834		
81753	Povrat danih zajmova HZMO-u, HZZ-u i HZZO-u po protestiranim jamstvima	835		

# Strategjia për Reformën e Sistemit të Raportimit Financiar – VËNIA NË ZBATIM

---

- Nëntor 2016 – shtesa dhe ndryshime në rregulloren për kontabilitetin buxhetor dhe planin kontabël.
- Këto ndryshime kanë të bëjnë në përgjithësi me transferimet e fondeve dhe transferimet brenda buxhetit të përgjithshëm.
  - Ndryshimet u bënë si pasojë e nevojës për konsolidim më të mirë.
- Të dhënat e mëparshme të planit kontabël, p.sh., për grantet nuk tregojnë nëse granti caktohet nga buxheti kombëtar apo nga buxheti nënkombëtar (i njësive vetëqeverisëse vendore dhe rajonale).
  - Të dhënat e treguara nuk mbështesnin identifikimin e nënsektorit të qeverisjes (qendror ose vendor), çka ka tejet rëndësi nga ana statistikore.

# Aktivitetet e ardhshme - projekti i BE-së

---

- Ngritja e një sistemi më efektiv të raportimit financiar dhe statistikor
- 522.000,00 euro

## Aktivitetet kryesore të projektit:

- **Projektimi i një aplikacioni të ri për mbledhjen dhe analizimin e pasqyrave financiare nga të gjitha njësitë raportuese** (buxhet kombëtar dhe nënkombëtar, (njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe rajonale) dhe përdoruesit buxhetorë dhe jashtëbuxhetorë sipas Regjistrimit të Përdoruesve Buxhetorë dhe Përdoruesve Jashtëbuxhetorë)
  - Projektimi i një aplikacioni të ri për mbledhjen dhe analizimin e pasqyrave financiare do ta thjeshtojë ndjeshëm raportimin financiar dhe mundësinë për t'i hartuar raportet statistikore në përputhje me kërkesat gjithnjë e më komplekse të vendosura nga MF.
- **Përpilimi i tabelave përkatëse për zhvillimin e metodikës së kontabilizimit për ngjarje të veçanta ekonomike.**
  - Në një shumicë vendesh të BE-së mbulimi buxhetor dhe statistikor i sistemit buxhetor të përgjithshëm nuk është identik dhe dallimet më të konsiderueshme janë identifikuar në mbulimin e përdoruesve jashtëbuxhetorë. Përdoruesit jashtëbuxhetorë mund të zbatojnë kontabilitetin buxhetor, si edhe kontabilitetin tregtar dhe kontabilitetin jofitimprurës, në varësi të formës së tyre juridike dhe veçantive operative. Kur përdoruesit jashtëbuxhetorë zbatojnë kontabilitetin tregtar ose kontabilitetin për OJF-të, në kuptim të raportimit financiar transaksionet tregtare duhet të kontabilizohen në përputhje me rregullat e kontabilitetit buxhetor. Në funksion të automatizimit të proceseve dhe përsheptimit të punës, do të kryhet një analizë për çdo përdorues individual jashtëbuxhetor dhe do të hartohet një metodë kontabilizimit në kontabilitetin buxhetor për çdo veprim të veçantë tregtar përmes përpilimit të tabelave përkatëse për përdoruesit e veçantë jashtëbuxhetorë duke u fokusuar te ngjarjet ekonomike të tilla si dorëzantë, shuarjet etj., të cilat e bëjnë procesin e konvertimit më të vështirë, dhe të gjitha me qëllim përmirësimin e cilësisë së raportimit statistikor në përputhje me metodikën ESA 2010.